



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**LEGJISLATURA V**

**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Mbledhja nr. 19

Prishtinë, më 15.07.2015 ora: 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

**Procesverbal**

**i mbledhjes së komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale**

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Xhevahire Izmaku, Alma Lama, Shqipe Pantina, Jelena Bontic dhe Zafir Berisha.

Mungoi: Pal Lekaj.

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit: MAP, OSBE, NDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 17.06.2015;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Procedurën e përgjithshme administrative;
4. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 17.06.2015;**

Procesverbali i dt. 17 qershor 2015, u miratua pa vërejtje.

**3. Shqyrtimi i Projektligjit për Procedurën e përgjithshme administrative;**

**Zenun Pajaziti** – duke theksuar se komisioni ka miratuar në parim P/ligjin, në Kuvend i kemi përcjell vërejtjet teknike për P/ligjin, të cilat vërejtje mund të vështirësojnë amendamentimin e P/ligjit, mirëpo për procedurën e amendamentimit kemi marrë zotimin e Ministrit të MAP-së që bashkë me ekspertët do të amendamentojmë P/ligjin. Tani ne do të caktojmë agjendën për formimin e grupit punues, që deri në muajin gusht në agjendë të kemi shqyrtimin e P/ligjit në

fjalë duke propozuar që grupi punues të përbëhet nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe në grup punues të përfshihen edhe përfaqësuesit e MAP-së.  
Ai pastaj hapi debat

**Zafir Berisha** - propozoi mbajtjen e dëgjimit publik dhe një punë më dinamike në mënyrë që në sesionin e vjeshtës të kemi gati P/ligjin për Kuvend.

**Xhevahire Izma**ku – tha se na duhet ndihma e sponsoruesit në fazën e amendamentimit, gjithashtu ajo propozoi që në grupin punues të jemi të gjithë anëtarët.

**Shqipe Pantina** - tha se çështje më me rëndësi në fazën e amendamentimit të P/ligjit është shqyrtimi i neneve të tekstit të P/ligjit nen për nen si dhe shqyrtimi i termeve të instituteve të reja në tekst edhe pse shprehu dyshimin që P/ligji do të kalojë në Kuvend. Lidhur me mbajtjen e dëgjimit publik për P/ligjin ajo kërkoi që ftesa të publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit, të ftohen përfaqësuesit e MAP-së dhe të gjitha grupet e interesit duke rekomanduar që komisionit do ti duhej një ekspertizë po aq sa MAP-së për të hartuar tekstin e P/ligjit.

Konstatim- komisioni vendosi që të mbahet dëgjimi publik të mërkurën me dt . 22 korrik 2015, në ora 11:00.

#### **4. Të ndryshme.**

**Shqipe Pantina**- njoftoi komisionin për pritjen jo të mirë që Departamenti i OJQ-ve në kuadër të MAP-së, ia kishte bërë grupit punues të Komisionit Parlamentar për monitorimin e Ligjit për OJQ-të.

Mbledhja përfundoi në ora:13:45

**Përgatitur nga:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit**

**Kryetari i Komisionit  
Zenun Pajaziti**

---